

NOVELË GRAFIKE ME DENARUSHIN



BASHKOJMË DHE MËSOJMË ME ÇDO NOVELË GRAFIKE
NË TË CILËN HEROI KRYESOR ËSHTË DENARUSHI



BANKA POPULLORE E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BOTUES:

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Bul. "Kuzman Josifovski - Pitu" nr. 1, 1000 Shkup

Telefon: (02) 3108 108

Faks: (02) 3108 357

<http://www.nbrm.mk/>

Redaktor: Kristina Pavleska

Autor: Kristina Pavleska

Bashkëpuntor: Olivera Panovska

Përkthim: Arian Limani dhe Leudita Musa

Lektorë: Arian Limani dhe Leudita Musa

Copyright: © 2018 Të gjitha të drejtat e botimit janë në pronësi të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Ndalohet kopjimi dhe riprodhimi i këtij materiali. Për përdorimin e të dhënave nga ky botim është e nevojshme të citoni burimin.

HYRJE

I dashur mik!

Në këtë Novelë Grafike me Denarushin do të shoqërohemi me Denarushin, Vëllaçkon dhe Motërzën. Përmes pyetjeve të vëllaut më të madh - Vëllaçkos dhe motrës më të vogël.

- Motërzës dhe përgjigjet e Denarushit të mençur, fillimisht do të njihemi me atë se **çfarë** punon Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë dhe cilat janë funksionet dhe detyrat e saj.

Pastaj do të udhëtojmë në histori dhe do të shohim se **çfarë** formash të parave kanë ekzistuar në të kaluarën, **çfarë** ekzistojnë tani, dhe do të lexojmë një tregim për arin. Do të mësojmë **çfarë** janë monedhat dhe kartëmonedhat, cilat janë monedhat dhe kartëmonedhat tona, elementet e sigurisë së parave tona - denarit maqedonas, si dhe për faktin se emetohen monedha për koleksionim.

Por, përveç monedhave dhe kartëmonedhave ekzistojnë edhe **kartela pagesore**, dhe me ndihmën e **kartelave pagesore**, në **bankomat** mund të tërhiqen para nga llogaritë tona të transaksionit.

Do të mësojmë **çfarë** është kursimi dhe kreditimi dhe se është mirë të kursehet sepse ai që kursen ka.

Në Bankën Popullore nuk mund të kursehet, mund të kursehet vetëm në bankat komerciale dhe shtëpitë e kursimit.

Kur udhëtojmë jashtë vendit duhet të kemi valuta të huaja - deviza, sepse denarët maqedonas mund t'i përdorim për pagesë vetëm në vendin tonë.

Do të mësojmë **çfarë** është inflacioni - kjo është një dukuri kur çmimet rriten, ndërsa Banka Popullore kujdeset të sigurojë stabilitetin e çmimeve.

Paratë duhet të shpenzohen me mençuri, të planifikohen të ardhurat dhe shpenzimet dhe të menaxhohet buxheti personal në mënyrë të mençur. Në këtë rast, nuk do t'i shpenzojmë të gjithë paratë që kemi, do të jemi të aftë të kursejmë ose t'i befasojmë të afërmit tonë - duke ju dhuruar diçka.

Le të shohim se si!



PARATË MAQEDONASE

PËRMBAJTJA

1.NJIHUNI ME BANKËN POPULLOLRE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	6
2.MONEDHA	7
3.KARTËMONEDHA.....	8
4.ELEMENTET E SIGURISË TË PARAVE MAQEDONASE	9
5.HISTORIA E PARAVE.....	10
6.TREGIMI PËRARIN.....	12
7.MONEDHA PËR KOLEKSIONIM	14
8.KARTELË PAGESORE - ÇFARË ËSHTË AJO	16
9.DENARUSHI DHE BANKOMATI.....	18
10.DEVIZA DHE VALUTA, ÇFARË JANË ATO?.....	20
11.KURSIMTARI I VOGËL.....	22
12.DENARUSHI DHE VLLAÇKOJA PYESIN VETEN... ÇFARË ËSHTË INFLACIONI?.....	26
13.PLANIFIKIMI I PARAVE - TË ARDHURA + SHPENZIME = BUXHET...28	
14.PLANIFIKIMI I PARAVE - ME NJË PLAN TË MIRË TË BUXHETIT - DERI NË KURSIM DHE SHPËRBLIM	30
15.EDHE NE JEMI PJESË E JAVËS GLOBALE TË PARASË	32
16.TË RIKUJTOJMË SE ÇFARË MËSUAM.....	34
17.KUIZ I NJOHURISË.....	36
18.DIÇKA MË TEPËR RRETH DENARËVE MAQEDONAS - A E DINI SE.....	38

NJIHUNI ME BANKËN POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë është institucion i cili e krijon dhe zbaton politikën monetare. Banka Popullore vendos për sasinë e parave (kartëmonedhave dhe monedhave që duhet të lëshohen në qarkullim), respektivisht sa monedha duhet të emetohen dhe sa kartëmonedha duhet të shtypen.

Ajo kujdeset që të mos lëshohen në qarkullim më tepër para dhe në këtë mënyrë të rriten çmimet, gjegjësisht të ketë inflacion.

Banka Popullore i kontrollon bankat, kujdeset për stabilitetin e sistemit financiar dhe sigurinë e depozitave të popullatës.

Banka Popullore ruan rezervat valutore.

Rezervat valutore ruhen në formë të monedhave prej ari dhe devizave të vlefshër

Në Bankën Popullore ka edhe farkëtari në të cilën farkëtohen denarët tanë.

Dëshironi të na vizitoni?

Jeni të mirëseardhur!

Mjafton shkollat të dërgojnë kërkesë për vizitë të Bankës Popullore përmes postës elektronike:

edukacija@nbrm.mk dhe

Banka Popullore do të organizojë një vizitë për ju, shokët tuaj dhe arsimtarët.



MONEDHA



Çdo vend ka paratë e veta. Paratë të cilat përdoren për pagesë në vendin tonë janë denarët maqedonas.

Ku dhe si bëhen denarët maqedonas?

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë ka të drejtën ekskluzive për emetim të denarit maqedonas.

Denarët maqedonas emetohen në formë të monedhave dhe kartëmonedhave.

Monedhat janë para metalike dhe ekzistojnë në vlera nominale prej: 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë.

MONEDHA NË QARKULLIM



KARTËMONEDHA



Kartëmonedhat janë para prej letre dhe mund t'i gjeni në vlera nominale:

10, 50, 100, 200, 500, 1000 dhe 2000 denarë.

Çdo monedhë dhe kartëmonedhë kanë pamjen e tyre të përparme (avers) dhe pamjen e prapme (revers).

Në paratë maqedonase shfaqen tipare nga territori i vendit tonë (për shembull, qeni i Sharrit në monedhën prej 1 denari, trofta e Ohrit në monedhën prej 2 denarësh, rreqëbulli malor në monedhën prej 5 denarësh, një pallua - mozaik nga Stobi në monedhën dhe kartëmonedhën prej 10 denarësh etj.).

KARTËMONEDHA NË QARKULLIM

PAMJA E PËRPARME
- AVERS



PAMJA E PRAPME -
REVERS



PARA ME PËRBËRJE
PLASTIKE (POLIMER)

PAMJA E PËRPARME
- AVERS



PAMJA E PRAPME -
REVERS



KARTËMONEDHA

ELEMENTET E SIGURISË TË PARAVE MAQEDONASE

Siç është e njohur, mjeti i vetëm ligjor për pagesa në Republikën e Maqedonisë është denari, ndërsa Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë ka të drejtën ekskluzive për shtypje dhe emetim të kartëmonedhave në Republikën e Maqedonisë.

Çdo kartëmonedhë ka elemente të sigurisë që të mos mund të falsifikohet. Por a e dini se si duken elementet e sigurisë së kartëmonedhave maqedonase?

Të gjithë kartëmonedhat përmbajnë më shumë elemente të sigurisë



Kështu duken elementet e sigurisë së kartëmonedhës prej 500 denarë:



Fleta metalike

Në brendësi të fletës metalike është shtypur numri 500, aplikacioni i një varseje-element kundër-kopjimit.



Filigrama (figura ujore) Filigramë (figurë ujore) regjistrimi në tre dimensione me paraqitjen e një maske mortore.



Filli i sigurisë fill i gjërë 2 mm me dritare, me mikrotekst të dukshëm НБМ.



Numërimi asimetrik Të gjithë numrat dhe shkronjat janë të ndryshme me madhësi të ndryshme



Shtypi i thellë Shtyp shumëngjyrësh i tekstit dhe gravurës.



Imazh i fshehur Në pjesën e poshtme të motivit bartës-maskës, nën një kënd të caktuar paraqitet shkurtesa НБМ.



Shtypi i thellë Ngjyrë e artë metalike (ndihet me anë të prekjës) me numrin 500 të ngulitur në këndin e djathtë.



Mikroteksti Në vijën e hollë mbi tekstin НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА



Elementi i regjistrimit Varëse antike, vizatimi i së cilës është i përbërë prej dy pjesëve, të cilat mbulohen nëse shihen kundrejt dritës.



Ngjyra shkëlqyese Shirit i ngjyrosur me një shtresë metalike ku nën një kënd të caktuar shihet flamuri i Republikës së Maqedonisë dhe numri 500.

HISTORIA E PARAVE

ELEMENTET E SIGURISË

PARATË

Sot do të zbulojmë se si u krijuan paratë

KARTËMONEDHAT

MONEDHAT



E dimë se paratë janë mjet pagese për këmbimin e mallrave. Paratë u shërbejnë njerëzve të blejnë ose të shesin ndonjë mall ose shërbim. Mirëpo, monedhat dhe kartëmonedhat nuk kanë ekzistuar gjithmonë.



Dikur, njerëzit kanë siguruar atë që ju është dashur me anë të këmbimit. Për shembull, një dele është shkëmbyer për pesë thasë grurë ose një kalë për dhjetë thasë oriz etj.



Në kohët e lashta njerëzit kanë përdorur shkëmbimin e llojeve të ndryshme të sendeve dhe produkteve si mjet për pagesë:

-sende të natyrës: gurë të çmuar, guaca, perla, grurë, kafë, çaj, duhan, kripë;

-produkte të ndryshme: mëndafsh kinez, enë qeramike, porcelan, stoli prej ari, argjend dhe bronz, sëpata, shpata dhe sende tjera personale.



Me zhvillimin e tregtisë ishte e nevojshme gjetja e mjeteve për pagesë që do të jenë të lehta për tu bartur dhe ndarë, të pathyeshme dhe të qëndrueshme.



10

Në historinë e parasë, metali luajti një rol vendimtar. Ai u tregua si një zgjidhje ideale për tregtarët, është i fortë, i ndashëm, i lehtë për përpunim, për tu njohur, për transport, i qëndrueshëm dhe i përhershëm.

Në Egjipt dhe Azi të Vogël, 2500 vjet para erës sonë, si mjet për pagesë janë përdorur metalet e çmuara (ari, argjendi dhe bakri).

Monedhat e para rrjedhin nga gjysma e dytë e shekullit të VII p.e.s, nga territori i Turqisë së sotme, nga mbretëria antike Lidia. Ata ishin prej

elekturmi, gjegjësisht prej përzierjes natyrale të arit me argjendin. Monedhat më të vjetra në Evropë janë paratë greke.



Monedha më e vjetër "Luani i Lidisë"



Kartëmonedha më e vjetër është paraqitur në Kinë. Nuk dihet data e saktë kur është emetuar, por kartëmonedha më e vjetër daton nga viti 840.



Në Evropë kartëmonedhat e para janë shtypur në vitin 1661 në Suedi.

Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, njerëzit kanë paguar me para. Pastaj kanë filuar të përdorin mjete tjera për pagesë, çeqe dhe kartela të ndryshme elektronike ose pagesore. Në kohën më moderne, pagesat kryhen përmes internetit.



Që nga shekulli i IV p.e.s. në monedha janë paraqitur fytyrat e njerëzve të famshëm. Pas vdekjes së Aleksandri Maqedonas (323 p.e.s) pasardhësit e konsideronin si perëndi dhe fytyra e tij paraqitet nëpër monedha.



TREGIMI PËR ARIN

A e dini se njerëzit dikurë kanë përdorur monedha të bëra prej ari?

Unë e di që ari është një metal dhe se gjendet në miniera.

Ndërsa unë e di që mami im më thërret "floriri im".

Është e saktë që ari është një metal i çmuar dhe gjendet nëpër miniera të caktuara nëpër botë, por gjithashtu mund të gjendet edhe nëpër shtratet e lumit ku mund të fitohet nga larja e rërës së artë.

Në të vërtetë? Kur është zbuluar ari për herë të parë?

Të dhënat më të vjetra për përdorimin e arit rrjedhin prej para 8000 viteve, diku në Azinë e largët. Ndërsa, përpara 3400 viteve është gjetur arka e sundimtarit Tutankamon nga Egjipti e përpunuar nga ari. Mbi të është paraqitur një maskë e artë në formë të fytyrës së sundimtarit.

Më herët, njerëzit kanë bërë monedha prej ari dhe me ato kanë kryer blerje dhe shitje. Sot nuk është kështu, por një pjesë e bankave qendrore në botë, siç është edhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, rezervat e tyre i ruajnë në formë të parave prej ari.

Sa interesante! Por sot, ku dhe si përdoret ari?

Domethënë, ari mund të ndryshojë formën e tij?

Po. Kurse njerëzit më shpesh kanë arë në formë të stolive siç janë unazat, qaforet, varëset etj.

Dhe si mund të matet se sa është vlera e arit?

Vlera e arit matet me para, ndërsa pesha matet me onca, gram dhe kilogram.

Një oncë është e barabartë me 31,1 gram ari ose 32,15 oncë janë të barabarta me një kilogram ari.

Onca, gram, kilogram - këto janë njësitë matëse për arin. A mësojmë me ndihmën e tyre se sa denarë kushton një unazë prej ari, qafore etj?

Po, vlera ose çmimi i arit mund të matet dhe të shprehet me valutën e dollarit amerikan. Një oncë ari kushton rreth 1340 dollarë, mirëpo për këtë do të mësoni më shumë kur të rriteni.



Denarush, po ti a je prej ari?

Jo, por unë jam "ari" i Motërzës dhe Vëllaçkos.

MONEDHA PËR KOLEKSIONIM

MONEDHA ME DOMETHËNIE TË VEÇANTË

Unë kam 105 denarë.

Unë kam 5 monedha:
një prej 1 denarë, një prej 2
denarë, dy nga 5 denarë, një
prej 10 denarë dhe
një prej 50 denarë...A e di
vëllaçko se sa para kam une?

Domethënë:
 $1 + 2 + (5 + 5) + 10 + 50 = 73$ denarë, ose
kemi total $105 + 73 = 178$ denarë dhe
plus Denaushin - 179 denarë

E saktë, mirëpo ekzistojnë edhe
monedha të cilat janë të reja,
shumë të bukura dhe të vlefshme.

Si është e mundur kjo?

Po është e mundur Vëllaçko, ato
janë ato çokolatat e vogëla që
duken si para prej ari që mund të
blehen në dyqan.

A, jo, nuk u dakordua ashtu, mos më
llogaritni mua!

Mirëpo, a e dini se ka edhe monedha
tjera të cilat përdoren në jetën e
përditshme? Me ato nuk mund të
paguani siç pagoni me këto monedha!

Unë e di. Ato janë monedha
që janë prodhuar në kohën
e lashtë, dhe tani më nuk
mund të përdoren. Mund të
gjenen dhe të shihen
vetëm në muze...

Jo, nuk janë ato. Edhe pse i preferoni, ato nuk vlejnë
aq shumë. Unë flas për ato monedhat të cilat janë të
rralla dhe të cilat emetohen në një numër të kufizuar,
dhe farkëtohen nga ari, argjendi ose metale tjera. Ato
janë monedha speciale të cilat quhen monedha për
qëllime speciale ose monedha përkujtimore.

Denarush, për çfarë
shërbejnë këto
monedha?

Monedhat për koleksionim i blejnë
njerëzit të cilët mbledhin sende artistike
dhe të rralla - dhe njihen si
koleksionerë.

A do të thotë
kjo se ata
njerëz kanë
albume për
monedha, siç
kemi ne albume
për fotografi,
ngjitëse etj?

Po, ashtu diçka - siç ju mblidhni fotografi, ngjitëse, rruzuj - ata ashtu bëjnë koleksione të mëdha të monedhave më të ndryshme nga e gjithë bota. Ato janë shumë interesante dhe të vlefshme.



Shumë dua të shoh ndonjë koleksion të atij lloji, mirëpo pyes veten se si duken paratë për koleksionim?

Monedhat për koleksionim farkëtohen për të shënuar ndonjë ngjarje të veçantë. Zakonisht janë të dizajnuara për atë që ata përfaqësojnë. Shpesh u kushtohen njerzëve të famshëm, monumenteve, institucioneve, ngjarjeve të rëndësishme nga historia e Republikës së Maqedonisë. Mirëpo, monedhat për koleksionim nuk mund të gjenden vetëm në Maqedoni. Çdo shtet përpunon monedha për koleksionim me simbolet e vendit të tyre.



Kush i bën këto para?




Monedhat për koleksionim i emeton Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë. Ja si duken disa prej tyre:

Tani e kemi të qartë. Sot mësuam çfarë janë monedhat për koleksionim. Ndërsa unë propozoj që ne të shkojmë dhe të blejmë para çokolade prej ari me denarët që kemi mbledhur.



KARTELA PAGESORE



Denarush, edhe unë dua të kem një kartelë pagesore si babi dhe mami. Dje, kur bënim pazar në supermarket, mami e frikësuar i tha babit se ka haruar portofolin në shtëpi dhe se nuk ka para të bëjë pagesën.



Mos u brengos, unë do t'i paguaj produktet.

Atëherë u habita, si mund babi të paguaj nëse nuk ka para me vete?



Haa, Vëllaçko, mos këtë paguar me letërnjoftimin e tij? Ose ndoshta me patentën e shoferit?

Jo, Denarush... Çfarë po flet, si mund të paguaj me letërnjoftim ose me patentë shoferi?

ÇFARË ËSHTË AJO?



Kartela, sipas madhësisë i ngjante si madhësia e letërnjoftimit ose patentës së shoferit, mirëpo babi më tregoi se kartela me të cilën pagoi është kartelë kreditore!

Atëhere, çfarë pret Denarush, më shpjego si mund të paguhet vetëm me kartelë?

Bëra pak shaka, unë shumë mirë e di çfarë është kartelë kreditore.



Shiko, kjo është një nga kartelat e shumëllojshme elektronike të synuara për pagesë të mallërave dhe shërbimeve të ndryshme. Kartela kreditore ose debit është kartelë me të cilën paguajmë kur blejmë diçka, mirëpo nuk paguajmë me para të gatshme (kartëmonedha ose monedha). Këto kartela merren në bankë ose ndonjë institucion tjetër financiar. Shpesh kartelat janë të lidhura me rrogën që marrin prindërit (kështu paratë regjistrohen në mënyrë elektornike).

A e ke tani të qartë se si ka paguar babi yt?

Po, por nuk e kam të qartë pse unë nuk kam një kartelë kreditore?

Edhe ti mund të kesh, mirëpo kur të mbushësh 18 vjet dhe të bëhesh i rritur. Ndërsa, deri atëherë kursej paratë të cilat t'i japin. Kur të kesh kartelë pagesore, do mund t'i fusësh mjetet e kursyera në llogarinë tënde të lidhur me kartelën.

Tani, le të luajmë shitës dhe blerës. Unë do të bëhem arkëtar, ndërsa ti do të bësh pazar në supermarketin tim. Si do të paguash, me para ose me kartelë kreditore?





DENARUSHI DHE BANKOMATI



Përshëndetje
fëmijë!
A e dini si quhet
ky aparat?

BANKOMAT! Ashtu
është!
Unë do ju shpjegoj
se çfarë funksioni ka
bankomati.

Në shtëpinë e Vëllaçkut dhe
Motërzës...

A e di se përveç që
mund të paguash me
para në dyqan mund të
paguash edhe me
kartelë pagesore?

Vërtetë?
Si është e
mundur kjo?

Thjeshtë!
Ajo është një
kartelë pagesore të
cilën e vendos në
një aparat të
veçantë afër arkës
- dhe paguan!

Por, ku janë Vëllaço dhe
Motërza?

O Zot, harova, shpejto,
bëhu gati. Denarushi na
pret përpara bankomatit.

Ku?

Shpejto, do të
shpjegoj
rrugës...

Përshëndetje
Denarush!

Përshëndetje Denarush,
Vëllaçoja më tregoi se
sot jemi këtu për të na
shpjeguar si funksionon
bankomati. Ndërsa unë
vazhdimisht pyes veten
çfarë do të thotë fjala
bankomat. A ka ndonjë
lidhje me bankën?

Fjala bankomat është krijuar nga fjalët **bankë** dhe **automat** dhe do të thotë **bankë automatike**. Bankomati mundëson shërbimin bankar pa praninë e njeriut. Për tu përdorur ky shërbim, nevojitet një kartelë pagesore. Funksioni kryesorë i bankomatit është që njerëzit të tërheqin para.

Kartela pagesore futet në një vend të caktuar në bankomat. Pastaj shënohet fjalëkalimi. Kështu bëhet qasja në të dhënat e llogarisë. Shënohet shuma që na nevojitet dhe bankomati jep paratë.

Kartela përmban elemente të cilat bankomati mund t'i njohë, siç janë çipi dhe shiriti magnetik. Kur i lexon ato, bankomati tregon gjendjen në llogarinë e përdoruesit i cili e posedon kartelën. Kështu duken ato elemente.

Ky bankomat është vendosur afër bankës, por kam parë edhe bankomatë të cilët janë vendosur në vende ku nuk ka një bankë.

Po, ato shpesh vendosen në vende ku lëvizin më shumë njerëz: nëpër supermarkete, qendra tregtare etj.

Denarush, si e nje bankomati kartën?

Gjithçka në kohën e duhur. Bankomatët do të ekzistojnë edhe kur të rriteni ju. Ndërsa, deri atëherë ka edhe shumë për tu mësuar dhe të zbulohet. Ja, erdhi koha për drekë, ndërsa bankomatët nuk përgatisin ushqim. Është koha të nisemi për në shtëpi.

Vëllaçko, a ke ti kartelë pagesore

Jo, akoma jam i vogël, por babi dhe mami kanë. Kam parë se si paguajnë me ato.

ky është shiriti magnetik

ky është çipi

DEVIZA DHE VALUTA, ÇFARË ËSHTË KJO?



Ua, Denarush, sa i lumtur që jam që do të shkojmë për fundjavë jashtë vendit tonë.

Edhe unë jam shumë e gëzuar! Dëgjova mamin se si thoshte se për festa do të udhëtojmë jashtë vendit tonë, mirëpo për këtë udhëtim do të nevojiten deviza. Ndërsa, unë nuk e di çfarë do të thotë fjala deviza, a e di ti Denarush?

Natyrisht që e di. Domethënë: kur qëndron në një shtet tjetër, kur blejmë diçka, nuk mund të paguajmë me denarë. Prandaj duhet t'i këmbejmë denarët në para tjera - para të cilat përdoren në vendin ku shkojmë. Për shembull, nëse jemi në Republikën e Serbisë, na nevojiten dinarë serb, nëse qendrojmë në Itali, do na nevojiten euro. Nëse jemi në Shqipëri, do na nevojiten lekë, ndërsa në Bullgari - leva.



Dhe ku mund t'i këmbejmë paratë?

Në çdo bankë ose këmbimore.

Dhe a kanë të gjithë paratë vlerë të njëjtë?

Natyrisht që jo. Një denar nuk është njëjtë me 1 euro. Një euro është e barabartë me diku 61 denarë. Kjo do të thotë që euroja është valutë më e vlefshme në raport me denarin. Por, nëse 1 euro është e barabartë me rreth 120 dinarë serb, kjo do të thotë se denari maqedonas është valutë më e vlefshme në raport me dinarin serb.

1 euro = 61 denarë maqedonas
1 euro = 120 dinarë serb



Denarush, ku qëndron dallimi mes fjalëve **valuta** dhe **deviza**?

Valutat janë njësi monetare - që do të thotë paraja e ndonjë vendi. Devizat janë mjete pagesore të emetura në valutë të huaj që përdoren për pagesë të thjeshtë jashtë vendit. Domethënë, devizat janë valuta të huaja - para me të cilat paguajmë në vendin ku qëndrojmë. Ja, unë do ju përmend disa valuta të njohura botërore: euro, dollari amerikan, franga zviceriane, funta britaneze, jeni japonez, rublja ruse, koruna norvegjeze, dollari australian.

Cila valutë është më e vlefshmeja?

Valuta më e vlefshme përdoret në shtetin Kuvajt dhe vlera e saj në raport me denarin tonë është:

1 dinar i Kuvajtit = 170 denarë maqedonas

Uaa, Denarush, ajo në të vërtetë është një valutë shumë e vlefshme. Por, për fat ne nuk shkojmë në Kuvajt, kështu do të kursejmë më shumë denarë maqedonas.

Ja se si duken disa nga valutat e njohura botërore.



euro



dollari amerikan



franga zviceriane



funta britaneze



dollari australian



rublja ruse





jeni japonez



korona norvegjeze

KURSIMTARI





BANKA

- Unë **kursej** në këtë bankë. Banka kujdeset për paratë e **kursimtarëve**.

Le të hyjmë brenda.

SPORTELI PËR KURSIMTARË

- Mirëdita fëmijë, si mundem t'ju ndihmoj?

- A mundem edhe unë të bëhem **kursimtarë** si vëllau im?

- Natyrisht që po, mirëpo për të të hapur një librezë **kursimesh** duhet të vish bashkë me prindërit.

- Unë i vendosa paratë që i mora për ditëlindjen time...

SPORTELI PËR KURSIMTARË

...në librezën e **kursimeve** dhe kështu e di që janë të sigurta dhe në shumë më të madhe.

SPORTELI PËR KURSIMTARË

- Bravo, ti në të vërtetë je një dajllë i mençur dhe kursimtarë i vlefshëm.

- A mund që kur të mbledh mjaftueshëm para t'i tërqeh nga librezë e **kursimeve**...



Denarushi dhe Vëllaçkoja pyesin veten...

Çfarë është inflacioni?



LIBRARIA



- Njerëzit i përdorin parat për të blerë ose shitur diçka, ndonjë produkt - siç janë për shembull lodrat, librat, albumet, librat për të ngjyrosur.



Për shembull, nëse duam të blejmë një çantë, duhet ta dimë se sa kushton, gjegjësisht ta dimë sa është çmimi i saj, nëse kemi para të mjaftueshme për ta blerë ate Kështu do ta përmbushim dëshirën tonë. Njerëzit i përdorin paratë gjatë blerjes dhe shitjes.

Çmimet tregojnë sa është vlera e asaj që dëshirojmë ta blejmë, por akom nuk e kam të qartë çka do të thotë INFLACION



Tani e kam të qartë: INFLACION është termi i cili tregon se produktet fitojnë çmim më të lartë, ndërsa paratë kanë vlerë më të vogël. Mirëpo, secili duhet ta dijë se Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë kujdeset për stabilitetin e çmimeve - kjo do të thotë se çmimet e produkteve nëpër dyqane nuk do të shtrenjtohen. Detyra e saj është të sigurojë çmime stabile që të mos rriten çmimet, gjegjësisht të mos vie deri te INFLACIONI.



Përshëndetje Vëllačko dhe Denarush. Kur kjo çantë do të ketë çmim më të lartë, kjo do të thotë se është shtrenjtuar. Atëherë paratë të cilat i keni nuk do të jenë të mjaftueshme për ta blerë. Ky shtrenjtim quhet INFLACION, atëherë paratë kanë vlerë më të ulët. Kjo do të thotë se duhet të keni më shumë para për të paguar vlerën.

LIBRARIA



ÇFARË KONSTATOI DENARUSHI?



INFLACIONI i lartë është një dukuri negative, sepse kur ka **INFLACION**, çmimet rriten, dhe vlera e parave zvogëlohet. Kjo do të thotë se me të njëjta para mund të blejmë më pak produkte ose për ta blerë produktin e njëjtë na duhen më shumë para.



Planifikimi i parave

$$\text{TË ARDHURA} + \text{SHPENZIME} = \text{BUXHET!}$$



Vëllaçko, sa e shijshme është simitja! Po ti çfarë je duke ngrënë, ku e ke simiten?

E kam ngrënë por nuk u ngopa. Prandaj bleva një kiflet me djathë. Sa është e shijshme dhe krokante.

Ashtu ë! E, mirë ke bërë. A, sa kushton ajo kifla yte krokante?

30 denarë. Mua gjyshja çdo ditë më jep nga 50 denarë, për çdo rast që të mos mbes i uritur.

Domethënë, nëse ke harxhuar 30 denarë të kanë mbetur edhe 20 denarë.

Jo, nuk më kanë mbetur.

E, si nuk i ke, ndoshta i ke humbur?

Jo, nuk i kam humbur. Motërzës i'a dhash paratë, i mungonin edhe 20 denarë për të blerë dy fletore të reja: një për matematikë dhe një për gjuhën maqedonase.

Bravo Vëllaçko, ju qenkeni fëmijë që dinë të kursejnë dhe të ndihmojnë. Shprehitë e mira mësohen që në fëmijëri. Por, a e di se si quhet kur dikush të jep para hua? Ose kur ti i jep dikujt ose i harxhon paratë?

Pra, kur fitojmë para - kjo është fitim, shpërbim dhe kur japim - shpenzim!

Po ashtu është, por duhet ta dini se çdo lloj të hyrash ose para të fituara njihen me emrin e njëjtë - **të ardhura**.

Të hyra? Të ardhura? Asgjë nuk e kam të qartë.

Fëmijët pranojnë para nga të rriturit. Ndërsa të rriturit marrin paga ose pension. Disa nxënës dhe studentë marrin stipendione. Para gjithashtu fitohen edhe në lojërat e fatit. Paratë mund edhe të trashëgohen nga familja, por si do qoftë, të gjitha llojet e të hyrave quhen të ardhura.

Tani e kuptova - të ardhurat e mia janë paratë të cilat i marr për drekë, ditëlindje ose ndonjë festë.

Po ashtu është, ndërsa kur shpenzojmë para, gjegjësisht blejmë ose paguajmë diçka, bëjmë shpenzime të caktuara - ato quhen me një emër - **shpenzime**.

Shpenzime?
Edhe një fjalë e re.

Mjafton Denarush, gjatë gjithë pushimit të gjatë folëm për të ardhurat dhe shpenzimet. Le të kthehemi në mësim, tani më nuk kam as të ardhura as shpenzime, dmth buxheti është i zbrastët.

Prandaj buxheti duhet të planifikohet me kujdes.

Më shpejt se ra zija për në klasë, për këtë do të më shpjegosh herën tjetër.

Po, është e rëndësishme se të gjitha llojet e harxhimeve quhen **shpenzime**. Të ardhurat dhe shpenzimet e një familjeje e përbëjnë **buxhetin** familjar.

Po, do të mësoj se si të bësh një tabelë për planifikim.

Planifikimi i parave

MENJË PLAN TË MIRË TË BUXHETIT - DERI NË KURSIME DHE SHPËRBLIME

Mësuam se të ardhurat - fitimet dhe shpenzimet - harxhimet e një familjeje përbëjnë **buxhetin** familjar.

Denarush, unë jam i padurueshëm, a nuk premtove që do të na mësosh se si bëhet një tabelë për planifikim të buxhetit?

Po, premtova që edhe këtë do ta bëjmë sot. Por, fillimisht duhet të dini se **buxheti** paraqet një plan financiar. Si çdo familje planifikon buxhetin e saj, buxhet gjithashtu ka edhe shteti, institucionet dhe sipërmarrjet në të cilat punojnë të rriturit. Të rriturit shpesh e bëjnë planin e tyre financiar ose buxhetin për një periudhë kohore një vjeçare.

Kjo mua më duket shumë e ndërlikuar dhe e vështirë. Unë nuk mund të planifikoj për një ditë, e paramendo për një vit.

Kjo është punë e të rriturve. Por, fëmijët duhet ta dinë se paratë të cilat fitohen, mund të kursehen, por edhe të harxhohen ose dhurohen. Ndërsa, për të pasur para në çdo kohë për nevojat të ndryshme, duhet të mësojmë të planifikojmë - të shohim se sa mund të harxhojmë nga paratë të cilat i fitojmë dhe sa mund të kursejmë ose të dhurojmë.

Kjo është tabela për ditën e sotme Vëllaçko.

Të ardhura (prej çka, kujt?)	Të ardhura (sa?)	Shpenzime (për çfarë?)	Shpenzime (sa?)	Total (denarë të kursyer)
nga gjyshja	50 denarë	kifle misri	-30 denarë	20 denarë
		dhuratë për Motërzën	-20 denarë	-20 denarë
totali i të ardhurave	50 denarë	totali shpenzimeve	-50 denarë	$50 - 50 = 0$ denarë

Nga kjo tabelë mund të shihet se kur shpenzimet zbriten nga të ardhurat, mund të llogaritet se sa kemi kursyer.

Sipas kësaj tablele - sa kam pasur, aq kam shpenzuar. Por, nëse në disa ditët në vijim jam në gjendje të kursej të paktën 10 denarë, kjo do të thotë se për 7 ditë mund të kursej 70 denarë.

Nëse bën një plan se si do të shpenzosh dhe kursesh, kjo do të thotë se e planifikon buxhetin!

Le të bëjmë një plan me llogaritje për një javë, duke filluar të hënë. Çdo ditë shënoni sa para fitoni, sa para mund të ruani, sa shpenzoni.

Plotësoni tabelën e paraqitur çdo ditë.

Në fund të javës do të dini sa para keni shpenzuar dhe sa keni kursyer.

Pastaj vetë bëni tabelë të re dhe vazhdoni të shënoni. Kështu do të zbuloni nëse mund të kurseni gjatë gjithë muajit. Nëse jeni të aftë të kurseni, do të përmbushni ndonjë dëshirë tuajën ose të dikujtë që e dashuron.

Dita	Të ardhura (prej çka dhe kujt?)	Të ardhura (sa?)	Shpenzime (për çfarë?)	Shpenzime (sa?)	Totali i parave të kursyera
e hënë					
e martë					
e mërkurë					
e enjte					
e premte					
e shtunë					
e diel					
fundi i javës	totali i të ardhurave		totali i shpenzimeve		

EDHE NE JEMI PJESË E JAVËS GLOBALE TË PARASË



Të dashur fëmijë, a e dini se në botë shënohet Java Globale e Parasë?

Java Globale e Parasë nën organizimin e Organizatës Ndërkombëtare për Edukim Financiar të fëmijëve dhe të rinjve mbahet në mars. Gjatë kësaj jave në gjithë botën organizohen aktivitetet të ndryshme edukative nga shumë institucione dhe organizata në të cilat përfshihen miliona fëmijë dhe të rinj.

Në të vërtetë? Kur është kjo javë? Çfarë ndodh atëherë?



Si përfshihemi ne, fëmijët e Maqedonisë?

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet tjera rregullatore do të kujdesen për këtë.

Mjafton që shkollat të dërgojnë kërkesë për vizitë të Bankës Popullore në postën elektronike: edukacija@nbrm.mk dhe Banka Popullore do të organizojë vizitë për ju, shokët tuaj dhe arsimtarët.

Do të vizitoni farkëtarinë ku do të shihni se si prodhohen denarët maqedonas, dhe do të vizitoni edhe Muzeun e Bankës Popullore ku do të shihni para shumë të vjetra të cilat janë përdorur në territorin e shtetit tonë në të kaluarën. Gjithashtu, do të mësoni çfarë punon Banka Popullore, do të mësoni për paratë, për kusimin, për bankat dhe shumë tema tjera përmes mësimdhënies interaktive dhe ligjeratave interesante.

Çfarë do të shohim atje? Çfarë do të mësojmë në Bankën Popullore?





A mund punonjësit e Bankës Popullore të vijnë në vizitë në shkollën tonë?



Dhe të na shpjegojnë si janë krijuar paratë, ku dhe si prodhohen, dhe si mund të kursejmë?



Natyrisht që po! Le t'i ftojë shkolla juaj dhe ata do t'ju vizitojnë dhe do t'ju përgjigjen të gjithë pyetjeve lidhur me paratë, kursimin dhe gjithçka që quhet edukim financiar.

DERI NË VITIN 2017, JAVA GLOBALE E PARASË KA PËRFSHIRË:



137
vende



24.433.000
fëmijë dhe të rinj



111.037
aktivitete



23,738
institucione



Monedha dhe kartëmonedha

Denarët maqedonas emetohen në formë të monedhave, kartëmonedhave dhe monedhave për koleksionim.

Paratë metalike quhen monedha dhe ekzistojnë në vlera nominale 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë.

Paratë prej letre quhen kartëmonedha dhe ato mund të gjenden në vlera nominale prej: 10, 50, 100, 200, 500, 1000, 2000 denarë.

Secila monedhë dhe kartëmonedhë ka anën e përparme (avers) dhe anën e prapme (revers). Ato paraqiten me veçori nga rajoni i vendit tonë (për shembull qeni i malit të Sharrit në monedhën prej 1 denarë, trofta e Ohrit në monedhën prej 2 denarë, rrëqebulli i malit në monedhën prej 5 denarë, palloi - mozaik nga Stobi në monedhën dhe kartëmonedhën prej 10 denarë etj.).

Banka Popullore ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhave për koleksionim në të cilat janë paraqitur vepra artistike të bëra nga metalet e çmuara - argjend, ari dhe në kombinim me gurët e çmuar.



Elementet mbrojtëse të parave maqedonase

Të gjitha kartëmonedhat përmbajnë më shumë elemente mbrojtëse: filigramë (figurë ujore), fill mbrojtës, shtyp të thellë, imazh të fshehur, mikrotekst, elemente regjistrimi dhe ngjyrë optikisht të ndryshueshme.

Këto elemente mbrojtëse përdoren për mbrojtjen e kartëmonedhave nga falsifikimi ose nga kopjimi i paligjshëm i kartëmonedhave origjinale.



Paratë nëpër historia

Në kohën e lashtë njerëzit kanë përdorur shkëmbimin dhe lloje të ndryshme të objekteve

dhe produkteve si mjet për pagesë:

objekte nga natyra - gurë të çmuar, guaca, perla, drithëra;

produkte të ndryshme - mëndafsh

kinez, enë të qeramikës, porcelan,

bizhuteri ari, argjendi dhe bronzi, sëpata, shpata etj. Monedhat e para rrjedhin nga gjysma e dytë e shekullit të VII-të p.e.s, nga Mbretëria e Lashtë e Lidisë. Monedha më e vjetër është paraqitur në Kinë.

Pastaj kanë filluar të përdorin lloje të ndryshme për pagesa: çeqe dhe kartela të ndryshme elektronike ose pagesore. Në kohën më moderne pagesat kryhen përmes internetit.



Buxheti

Mësuam se si ta llogarisim buxhetin personal.

Të ardhurat janë të gjitha llojet e hyrjeve ose parave të fituara, ndërsa daljet janë të gjitha shpenzimet. Tani dimë se si të bëjmë një tabelë për llogaritjen e buxhetit tonë personal.



Ari


Mësuam edhe për arin, si përdoret, si matet dhe cila është vlera e tij. Mësuam se është shumë i vlefshëm. Vlera e tij matet me onsa dhe shprehet në dollarë amerikan. Nga ari prodhohen monedha, bizhuteri dhe zbukurime të ndryshme, por përdoret edhe si ari monetar në formë të shufrave prej ari për rezervat valutore.



ÇFARË MËSUAM

Kartela pagesore

Mësuam çfarë është një kartelë pagesore. Ekzistojnë kartela krediti dhe debiti të cilat merren në bankë. Më shpesh lidhen me pagën që e marrin prindërit. Kartelat pagesore janë mjete elektronike për pagesa dhe përbajnë informacione për fondet monetare të bartësit të kartelës. Kartelat i përdorim kur dëshirojmë të blejmë diçka dhe nuk kemi para të gatshme me vete.



Bankomat

Është një makineri që mundëson një shërbim bankar pa prezencën e njeriut. Për të tërhequr para nga llogaria jonë në një bankomat, na nevojitet një kartelë pagesore.



Kartela përmban elemente të cilat bankomati mund t'i njohi, siç janë çipi dhe shiriti magnetik. Kur i lexon ato, bankomati e shfaq gjendjen e llogarisë së përdoruesit të kartelës.

Kursimi

Mësuam se nuk mund të kursejmë në Bankën Popullore. Mund të kursehet në bankat komerciale, dhe çdo kursimtar merr një librezë kursimesh. Paratë të cilat kursimtar i investon në bankë, gjegjësisht librezën e tij të kursimit, quhen depozitë, dhe për paratë e investuara banka ju paguan interes. Interesi është më i lartë kur kursehet në denarë, dhe më i ulët kur kursehet në valutë të huaj (euro, dollarë etj.).



Deviza dhe valuta

Devizat janë mjete pagesash të emetuara në valutë të huaj që zakonisht përdoren për pagesa në vendet e huaja. Valutat janë njësi monetare, gjegjësisht para të një vendi, siç është denari i Republikës së Maqedonisë.



Java Globale e Parasë

Java Globale e Parasë shënohet çdo mars të vitit në të gjithë botën. Gjatë Javës së Parasë organizohen aktivitete të ndryshme edukative nga institucionet dhe organizatat e shumëta në të cilat miliona dhe të rinjë.



Inflacioni

Kur ka inflacion, çmimet rriten dhe zvogëlohet vlera e parasë. Kjo do të thotë se me paratë e njëjta mund të blejmë më pak produkte ose për produktin e njëjtë që e blejmë rregullisht do të na nevojiten më shumë para.



1. Kush i emeton paratë maqedonase?

- a) Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë
- b) Bankat komerciale
- c) Fabrikat

2. Bankomati është makineri e cila shërben për kryerjen e transaksioneve bankare.

PO JO

3. Secili fëmijë deri në moshën 12 vjeçare mund të posedojë kartelën e tij për pagesa.

PO JO

4. A mund të kursehet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë?

PO JO

5. A fitojmë interes për fondet e investuara në një bankë?

PO JO

6. Çfarë është buxheti?

- a) vetëm të ardhurat
- b) vetëm shpenzimet
- c) të ardhurat dhe shpenzimet



KUIZ



7. Inflacioni është:

- a) Kur produktet fitojnë çmim më të ulët
- b) Kur produktet fitojnë çmim më të lartë
- c) Kur çmimi i produkteve mbetet i njëjtë

8. Kartela e kreditit ose debitit është një kartelë pagesore që e përdorin të rriturit si mjet pagesash kur blejnë ose paguajnë.

PO JO

9. Sa denarë vlen një euro?

- a) 35 denarë
- b) 61 denarë
- c) 100 denarë

10. Me cilën valutë të huaj paguajmë në vendet e euro zonës?

- a) Euro
- b) Dinar
- c) Denar



Përgjigjet e sakta mund t'i gjeni në faqen 38.



A E D I N I S E

- Kartëmonedhat maqedonase prodhohen nga letra me cilësi të lartë e përbërë prej 100% fijesh pambuku.
- Monedhat janë me vlerë më të ulët nominale prej 1, 2 dhe 5 denarë (emetimi i vitit 1993) dhe përbëhen nga përzierja e bakrit (80%), zinkut (17%) dhe nikelit (3%).
- Vlerat më të larta nominale prej 10 dhe 50 denarë janë lëshuar në qarkullim në vitin 2008. Monedhat prej 10 denarë përbëhen nga përzierja e bakrit (70%), zinkut (18%) dhe nikelit (12%), ndërsa 50 denarë prej bakrit (62%), zink (20%) dhe nikel (18%).
- Kartëmonedhat me vlerë nominale 5000 denarë, për shkak të vlerës së tyre të lartë nominale dhe përfaqësimit të tyre të kufizuar gjatë realizimit të transaksioneve me para të gatshme, janë tërhequr nga qarkullimi dhe nuk janë më mjet për pagesë nga 15 dhjetori i vitit 2016.
- Paratë me përbërje plastike - polimer me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë hynë në qarkullim më 15 maj të vitit 2018.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë • Bul. "Kuzman Josifovski - Pitu" Nr. 1
1000 Shkup • Republika e Maqedonisë • Tel. 02/3108 108 • www.nbrm.mk